

Si shumë prindër të tjerë me fëmijë të vegjël, edhe ju mund të shqetësoheni për shëndetin e fëmijëve tuaj dhe mbrojtjen e tyre nga COVID-19.



Por ka lajme të mira: Vaksina e COVID-19 tash ofrohet edhe për fëmijët në moshat 5 vjeç e lart. **Ekspertët pajtohen se kjo është mënyra më e mirë për t'u mbrojtur nga COVID-19 dhe për të parandaluar që fëmijët të sëmuren rëndë.**

Është krejt e natyrshme që të keni pyetje për vaksinën dhe fëmijën tuaj. Këtu poshtë jepen disa fakte:

- Vaksina Pfizer është miratuar për fëmijët në moshën 5 vjeç e lart.
- Është provuar të jetë efektive në masën 91% në parandalimin e infektimit tek fëmijët.
- Vaksinat COVID-19 janë rigorozisht të testuara.
- Në provat klinike të vaksinës Pfizer u përfshinë 2,200 fëmijë të moshës 5-11 vjeç.



A dëshironi që të mësoni më shumë?
Konsultohuni me mjekun e fëmijës
për vaksinën COVID-19.

mass.gov/CovidVaccineKids